



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1112/2 prot.

Tiranë më 30.7.2019

Lënda: Dhënie mendimi lidhur me mundësinë e ofrimit të shërbimit “online” të “Treguesit Emëror të Pronave” nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

#### DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE

Tiranë

Bazuar në kërkesën tuaj për mendim nr.7722 prot, datë 15.07.2019, administruar nga ana jonë me nr.1112 prot, datë 17.07.2019, “*lidhur me mundësinë e ofrimit të shërbimit “online” të Treguesit Emëror të Pronave nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave*”, dhe në vijim të takimit informues midis përfaqësuesve të institucioneve tona, mbajtur në datën 23.07.2019 pranë ambienteve tona, Zyra e Komisionerit ka analizuar argumentet ligjore të paraqitura nga ana juaj me shkresën nr.7722/1 prot, datë 25.07.2019, në raport me parashikimet e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Paraprakisht, Zyra e Komisionerit, si edhe në raste të tjera të ngjashme, vlerëson dhe mbështet iniciativa të tilla inovatore në ofrimin e shërbimeve publike, që kanë si qëllim rritjen e performancës dhe transparencës institucionale dhe garantimin e interesit publik.

Kategoritë e të dhënave personale që përmban “Treguesi Emëror i Pronave”, janë emri, atësia dhe mbiemri. Në këtë kuadër përpunimi i tyre (duke përfshirë edhe publikimin) duhet të kryhet në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar.

Më qëllim që përpunimi dhe konkretisht publikimi i këtyre të dhënave të konsiderohet i ligjshëm është e nevojshme që të plotësohet një nga kriteret ligjore të përpunimit, të parashikuara në nenin 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*”, i ndryshuar.

Në rastin tuaj, përpunimi/publikimi duhet të gjejë mbështetje në një parashikim ligjor konkret (Ligji 9154 “Për Arkivat”) me qëllim që publikimi të konsiderohet i ligjshëm.

Në këtë kuadër, duke vlerësuar rëndësinë e këtij procesi dhe me qëllim garantimin e një përpunimi të ligjshëm të të dhënave personale nëpërmjet ofrimit të shërbimit “online” të “Treguesit Emëror të Pronave”, është e nevojshme që nga ana juaj të ndërmerren masat si vijon:

- Të kryhet informimi paraprak i subjekteve të të dhënave personale (qytetarët të dhënat e të cilëve do të publikohen) referuar nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar;  
Një mënyrë efektive e informimit mund të jetë hartimi dhe publikimi në faqen tuaj zyrtare i “Politikës së privatësisë” e cila ka si synim informimin e subjekteve të të dhënave personale dhe publikut të gjerë për fushën dhe qëllimin e përpunimit të të dhënave personale (për këtë proces përpunimi), funksionarët që kryejnë përpunimin (jo emrat por funksionin), mënyrën e përpunimit, të drejtat që gëzojnë subjektet e të dhënave (nenet 12-17 të ligjit) dhe masat teknike organizative për sigurinë e të dhënave (shkurtimisht pasi më gjerësisht duhet ti parashikojë rregullorja e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale).
- Të merren masa konkrete teknike dhe organizative, për garantimin e sigurisë online të të dhënave personale, nëpërmjet hartimit të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar;
- Përpara fillimit të këtij procesi përpunues, të realizohet njoftimi i përpunimit pranë Zyrës së Komisionerit, sipas nenit 21 të ligjit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**  
**Besnik Dervishi**

